

**Kompania Rajonale e Ujësjellësit
“HIDRODRINI” SH.A.**

**Raporti i auditorit të pavarur
dhe pasqyrat financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

| Përbajtja | Faqe |
|---|--------|
| Raporti i Auditorit të Pavarur | |
| Pasqyra e pozicionit finansiar | 1 |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse | 2 |
| Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar | 3 |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë | 4 |
| Shënimet në pasqyrat financiare | 5 - 23 |

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Shoqërisë

6 prill 2021

Opinioni ynë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të KRU Hidrodrini SH.A. "Shoqëria" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshëm të çështjeve të përshkruara në seksionin baza për opinion të kualifikuar në raportit tonë, pasqyrat financiare individuale paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale te pozitës financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit financiar (SNRF).

Bazat për Opinion të kualifikuar

1. Shoqëria ka njojur një rezervë të rivlerësimit prej EUR 21,744,554 (31 Dhjetor 2019: EUR 21,744,554) që është njojur në bazë të raportit të vlerësimit të kryer në vitin 2007. Qe nga koha e vlerësimit deri me date të raportimit të pasqyrave financiare nuk është bere rishikimi të vlerës të vlerësimit dhe as rivlerësim edhe pse ka kaluar një periudhe prej 13 vite nga data e vlerësimit, duke marr per baza qe gjendja ekonomike te ndërmarrjes dhe po ashtu edhe kushtet e tregut kan ndryshuar nga data e vlerësimit. SNRF dhe SNK përkatese kerkojne qe ne rast qe asetat mbahen me vlerën e drejt te tregut te behet rishikim vazhdushem i vleres se drejt te pasurive dhe po ashtu pas disa peridha te merret ne konsiderat nevoja per te bere rivlerësimi pasurive qe mbahen me vlere te drejt te tregut.

Per me teper, per tokat e prezantuara si pasuri te kompanise ne shume prej EUR 2,304,350, ne baze te dokumenteve te pronesise te ofruara nuk jane ne pronesi te KRU Hidrodrini perveq nje toke ne vlere prej EUR 144,000.

2. Sic është shpalosur në Shënimin 7 të pasqyrave financiare, llogaritë e arkëtueshme janë EUR 12,414,863 (31 dhjetor 2019: EUR 11,678,612) neto nga provizionet për borxhe të këqija dhe të dyshimta në vlerë prej EUR (6,443,159) (31 dhjetor 2019: EUR (6,604,249). Nje shume e konsiderueshme nga ky provizion ishte njojur viteve të mëparshme, ndërsa për vitin 2020, Shoqëria ka bërë një vlerësim të pjesërishëm të provizionit duke u bazuar vetëm në ditë vonesa sipas grupeve. Në nuk ishim në gjendje për të vlerësuar nëse do të kishte qenë e nevojshme provizionim shtesë në llogaritë e arkëtushme dhe në çfarë niveli si pasojë e mungesës së informacionit adekuat si rezultat te mos mbeshtetje me informacion nga softueri i perdonur. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vertetojmë nëse Shoqëria do jetë në gjendje të inkasojë vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezantuara. Shoqëria nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbeshtësin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me balancën e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2020. Përmëtepër, shoqëria nuk ka aplikuar në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në lidhje me provizionimet e llogarive të arketushme. Ne mungesë të analizave historike të kërkuar nga SNRF 9, për kalkulimin e provizioneve në llogarit e arkëtushme në nuk mund të vlerësojmë se sa do mund të jetë efekti në provizionim nëse do përfillin në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në kalkulimin e provzionit.
3. Sic eshte shpalosur ne Shenimin 9 kompania ka njojur te hyra te shtyra ne vlere prej EUR 27,575,337 (31 dhjetor 2019: 21,759,745) si dhe ka njojur te hyrat perkatese per vitin 2020 prej EUR 898,690 (31 dhjetor 2020: 469,253) sic eshte shpalosur ne shenimin 12. Sidocoft, gjatë auditimit ne kemi verejtur që Shoqeria nuk mban një listë të të hyrave të shtyra per asetet donacione si munges e një moduli adekuat te menagjimit te aseteve. Shoqëria ka perpiluar një llogaritje të përbledhur në excel e cila permban vetëm shumat totale te faturave per asetet e blera nder vite, per rrejdhoje ne nuk ishim në gjendje për të rillogaritur zhvlerësimin për pasuritë nga donacionet ne pamundesi te lidhjes se ketij regjistri ne excel me asetet përkatese në regjistrin e mjeteve themelore.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve dhe kërkesave janë përshkruar më tej në seksionit raportit tonë për përgjegjësi të e auditorit për auditimin e të pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarrur për kompanin në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve' Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike të / L-032 Ligji Nr 6 (për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat janë relevante Auditimi ynë i pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidanca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështje kryesore të auditimit

Çështjet kryesore te auditimit janë ato çështje qe, sipas gjykimit tone profesional, ishin me te rëndësishmet ne auditimin tone te pasqyrave financiare individual te periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan ne kontekstin e auditimit tone te pasqyrave financiare ne tërësi, dhe ne formimin e opinionit tone mbi ato, dhe ne nuk japid një opinion te veçante për këto çështje. Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë, ne nuk kemi përcaktuar çështjet të tjera si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin e përfshirë në raportin menaxhmentit, informacione te cilat nuk jane te ne pasqyra financiare te shoqërisë.

Mendimi ynë për pasqyrat financiare individuale nuk përfshin informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim asnjë formë të përfundimit të sigurimit mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, përgjegjësia jonë është që lexoni informacionin tjetër dhe, duke bërë këtë, merrni parasysh nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare të individual ose duke u bazuar në njohuritë tona të marra në auditim ose në të kundërt duket se janë gabim materiale. Bazuar në punën që kemi kryer, konstatojmë se nuk ekziston një gabim material i këtij informacioni tjetër, ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë të audituar nga një auditor tjetër i cili opinion daton më 19 qershor 2020 dhe shprehte një opinion te pa kualifikuar.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe të Ngarkuarit me Qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar në vijimësi, shpalosjen, sipas rastit, çështjet që lidhen vazhdimin në vijimësi dhe duke përdorur bazën kontabilitetit per vazhdimin në vijimësi, perveq nëse Menaxhimit ose synon të likuidojë kompanisë ose të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste, perpos për ta bërë këtë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel të lartë të sigurise, por nuk është

një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale kur ajo ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit ne përgjigje ndaj këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit te një pasaktësie materiale që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se për një pasaktësi që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretim apo shkelje e kontolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontolleve të brendshme relevante për auditimin me qëllim hartimit te procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim te shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Kolaudojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Menaxhmentit të bazës se kontabilitetit për te vazhduar ne vijimësi dhe në bazë të dëshmive të marra të auditimit, dhe nëse një pasiguri material ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar për të térhequr vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj shpalosjeve të lidhura në pasqyrat financiare ose, nëse shpalosjet e tillë janë të pamjaftueshme, për të modifikuar opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në prova e auditimit të marra të deri në datën e Raportit të Auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompanisë të ndërpres së qeni sipas bazës së vazhdimit në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në një mënyrë që arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me të ngarkuarit me qeverisje në lidhje me, mes çështjeve të tjera, shtrirjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollot e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu sigurojmë të ngarkuarit me qeverisje me një deklaratë që jemi në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ta të gjitha marrëdhëni të rëndësishme që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë, dhe kur është e zbatueshme, masa mbrojtëse te lidhura.

Nga çështjet komunikuara me të ngarkuarit me qeverisje, kemi përcaktojme ato çështje që janë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorit përvëç kur ligji apo rregullorja e pengon zbulimin publik në lidhje me këtë çështje, ose kur, në rrethana shumë të rralla, përcaktojmë që një çështje e nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat negative e të bërit këtë në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të peshoj më shumë përfitimet e interesit publik nga komunikimi i tillë.

Raporti mbi kërkesat tjera ligjore dhe rregullative

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale te shoqërisë Hidrodrini SH.A., si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar ne kërkesat ligjore te përcaktuara tek neni 10 ne ligjin Nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Sipas mendimit tonë raporti i menaxhmentit është ne përputhje me pasqyrat financiare për vitin finanziar raportues si dhe është përgatitur ne përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim neni 7, dhe te udhëzimit administrative Nr. 07/2019 për Strukture, Përbajtjen dhe Dorëzimin e Raporteve Financiare.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga organizata në përputhje me Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Kontabilisteve te Etikës se Kontabilistëve Profesionistë (Kodit IESBA) dhe te kërkesave te ligjit nr.06/L-032, ne i kemi përbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA dhe kërkesat ligjore qe dalin nga ligji Nr.06/L-032 dhe nga Udhëzimi Administrative nr. 02/2019.

Ne nuk kemi ofruar shërbime te tjera tek organizata te cilat janë te përcaktuar me Udhëzimi Administrative nr.02/2019.



Xhevdet Beqiri,
Auditor Ligjor



6 prill 2021

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH.A.- PEJË**



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156

30000 Pejë

Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Deklarata e pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare të shoqërisë KRU Hidrodrini SHA. që përfundojnë me datë 31 dhjetor 2020.

Menaxhmenti i shoqërisë (Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtori Financiar) deklarojnë që pasqyrat financiare të shoqërisë KRU Hidrodrini SHA të cilat përfundojnë me datë 31 dhjetor 2020 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhës së parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe kërkesave ligjore dhe në veçanti me kërkesat e Ligjit Nr.06/L-32 Për kontabilitet, Raportim finansiar dhe auditim.

Drejtori Ekzekutiv

(Agron Tigani, Neneshkrimi)

Drejtori Financiar

(Rasim Maloku, Neneshkrimi)



(Peje, 6 prill 2021)

KRU "Hidrodrini SH.A"

Pasqyra e posicionit financiar më 31 dhjetor 2020
(Shumat në Euro)

| Shënim i | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|--|--------------------|--------------------|
| Pasuria | | |
| Pasuria jo-rrjedhëse | | |
| Toka, Prona dhe pajisjet | 5 15,664,401 | 17,064,738 |
| Investimet ne vijim | 5 16,132,439 | 7,749,631 |
| Gjithsej pasuria jo-rrjedhëse | 31,796,840 | 24,814,369 |
| Pasuria rrjedhëse | | |
| Stoqet | 6 509,590 | 517,497 |
| Të arkëtushmet tregtare dhe te tjera | 7 12,531,139 | 11,798,360 |
| Parapagimet dhe kerkesat tjera | | 302,568 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parase | 8 6,061,074 | 7,756,047 |
| Gjithsej pasuria rrjedhëse | 19,404,371 | 20,071,904 |
| Gjithsej pasuria | 51,201,211 | 44,886,273 |
| Kapitali dhe detyrimet | | |
| Kapitali dhe rezervat | | 21,769,554 |
| Fitimet (humbjet) e akumuluara | | (1,123,212) |
| Fitimi (humbja) e vitit | | 327,267 |
| Gjithsej kapitali | 20,973,609 | 20,646,342 |
| Detyrimet jo-rrjedhëse | | |
| Të hyrat e shtyera | 9 27,575,337 | 21,759,745 |
| Kreditë, Huazimet afatgjata | | - |
| Gjithsej detyrimet afatgjata | 27,575,337 | 21,759,745 |
| Detyrimet rrjedhëse | | |
| Detyrimet afatshkurtëra | | |
| Të pagueshmet tregtare dhe te tjera | 10 377,715 | 119,393 |
| Tatimet e pagueshme | 11 2,274,550 | 2,360,794 |
| Gjithsej detyrimet rrjedhëse | 2,652,265 | 2,480,187 |
| Gjithsej kapitali dhe detyrimet | 51,201,211 | 44,886,274 |

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare
Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar në emër të menaxhmentit më 6
prill 2020.

Agron Tigani

Kryeshefi ekzekutiv

Rajim Måloku

Zyrtar Kryesor
Financiare

Kastrriot Zhavelli

Kontabilisti i certifikuar



KRU “Hidrodrini SH.A”

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për fund vitin 31 dhjetor 2020
(Shumat në Euro)

| Shënimet | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|---|--------------------|--------------------|
| Te hyrat | | |
| Te hyrat nga shitja | 12 | 3,795,599 |
| Te hyrat tjera | 12 | 1,194,293 |
| Gjithsej te hyrat | | 4,989,892 |
| | | 4,441,489 |
| Shpenzimet | | |
| Shpenzimet e shpërndarjes | 13 | 2,219,366 |
| Shpenzimet administrative | 14 | 2,443,259 |
| Gjithsej shpenzimet | | 4,662,625 |
| | | 4,194,100 |
| Fitimi (Humbja) operative | | 327,267 |
| Tatimi në fitim | 15 | - |
| Fitimi neto për vitin | | 327,267 |
| | | 213,642 |
| Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse | | - |
| Totali i të hyrave gjithëpërfshirëse për vitin | | 327,267 |
| | | 213,642 |

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KRU “Hidrodrini SH.A”

Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet ne fund vitin 31 dhjetor 2020
(Shumat në Euro)

| | Kapitali aksionar | Rezervat tjera | Fitimet (humbjet) e akumuluara | Gjithsej |
|---|----------------------|-------------------|--------------------------------------|-------------------|
| Balanca më 1 janar 2019 | 25,000 | 21,744,554 | (1,336,854) | 20,432,700 |
| Fitimi neto për vitin | - | - | 213,642 | 213,642 |
| Të ardhurat tjera | - | - | - | - |
| gjithëpërfshirëse për vitin, neto pas tatimit në fitim | - | - | - | - |
| Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin | - | - | 213,642 | 213,642 |
| Rregullimet | - | - | - | - |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 25,000 | 21,744,554 | (1,123,212) | 20,646,342 |
| Balanca më 1 janar 2020 | 25,000 | 21,744,554 | (1,123,212) | 20,646,342 |
| Fitimi(humbja) e vitit 2020 | - | - | 327,267 | 327,267 |
| Të ardhurat tjera | - | - | - | - |
| gjithëpërfshirëse, neto pas tatimit ne fitim | - | - | - | - |
| Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin | - | - | 327,267 | 327,267 |
| Rregullimet | - | - | - | - |
| Gjendja më 31 dhjetor 2020 | 25,000 | 21,744,554 | (795,945) | 20,973,609 |

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KRU “Hidrodrini SH.A”

Pasqyra e rrjedhës së parasë për fund vitin 31 dhjetor 2020
 (Shumat në Euro)

| Shënimë | Më 31 dhjetor | Më 31 dhjetor |
|--|--------------------|--------------------|
| | 2020 | 2019 |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative: | | |
| Fitimi i vitit para tatimit | 327,267 | 216,642 |
| <i>Regullimet për:</i> | | |
| Zhvlerësimi | 5 | 1,590,925 |
| Rrjedha operative e parasë para ndryshimeve në kapitalin punues | 1,918,192 | 1,822,061 |
| Ndryshimet në të arkëtueshme tjera | (302,568) | - |
| Ndryshimet në llogarit e arkëtueshme tregtare | 7 | (732,779) |
| Ndryshimet në të pagueshmet tregtare dhe të tjera | 258,322 | 40,651 |
| Ndryshimet ne stoqe | 6 | 7,907 |
| Ndryshimet në dhe të hyrat e shtyera | 13 | 5,815,592 |
| Ndryshimet në pasuritë tjera | | - |
| Ndryshimet në detyrimet tatimore | | 2,885 |
| Paraja neto nga aktivitetet operative | 6,878,422 | 8,445,422 |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese: | | |
| Blerja e pronës, ndërtesave dhe pajisjeve | (8,573,394) | (6,829,756) |
| Rrjedha neto e parasë e përdorur në aktivitetet investuese | (8,573,394) | (6,829,756) |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese | | |
| Arkëtimet nga interesë | | - |
| Rrjedha neto e parasë e përdorur në aktivitetet financuese | | - |
| Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit | 8 | (1,694,972) |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit | | 1,615,666 |
| | | 7,756,046 |
| | | 6,061,074 |
| | | 7,756,046 |

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

1. Informata mbi Kompaninë

KRU “Hidrodrini” SH.A., Pejë më tutje “Kompania” është shoqëri aksionare e inkorporuar me 01.06.2007 ne Kosovë , sipas Projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit ne Kosovë me numer te biznesit:70433918, numer fiskal 600198867 dhe Numer Unik Identifikues 811336975.

Kompania eshte themeluar ne pajtim me ligjin mbi shoqerine tregetare 02/L-123. Adresa e zyres qendore te regjistruar eshte ne rrugen: Lekë Dukagjini nr.156, Pejë,Kosovë.

KRU “Hidrodrini” SH.A. eshte institucion publik profesional i licencuar nga Autoriteti Rregullator per Sherbimet e Ujit, per ofrimin e sherbimeve baze, te furnizimit me uje te pijshem dhe sherbimet

kanalizimit.

Numri i popullatës qe KRU “Hidrodrini” iu kryen sherbime me uje te pajes vlerohet rreth 185,000 banor, ndersa sherbimet e ujerave te zeza 60,000 banor.

Aktiviteti Primar: Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me uje.

Aktiviteti Sekondar:Testi i shpuarjes dhe shpuarja.

2. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra finanicare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkontëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), te adaptuara nga KKRF per Kosove.

3. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkontëtare të Raportimit

3.1 Standardet e nxjerra por jo ende efektive

Një numër standardesh të reja dhe ndryshimet në standarde janë efektive për periudhat vjetore qe fillojne pas 1 janarit 2020 dhe aplikimi i hershem eshte i lejuar; megjithatë, përvèç kompania nuk ka miratuar më herët standardet e reja dhe të ndryshuara në përgatitjen e tyre pasqyrat financiare.

Standardet e mëposhtme të reja dhe të ndryshuara nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në Pasqyrat financiare te Kompanise:

- Kontrata të rënda - Kostoja e Përbushjes së Kontratës (Ndryshimet në SNK 37).
- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 (Ndryshim në SNRF 16)
- Prona, impiantet dhe pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16).
- Referencia në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3).
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente (Ndryshime në SNK 1).
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit dhe ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit.

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

4. Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

4.1 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në EURO, e cila është monedha funksionale e kompanisë.

4.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Toka, Ndertesat dhe Makinerit janë te mbajtura ne pasqyrat e pozitionit financiare ne vleren e tyre te rivlersuara, sipas vlerese se tyre te dates se rivlersimit, zbritur per zhvlersimet e akumuluar dhe te shlyrjeve te munehme. Rivlersimi eshte bere sipas rregullave dhe metodave adekuate sikur qe vlera e mbetur e tyre nuk ka diferenca material nga ato qe do te percaktojne vleren e derjt te tregut ne fund te qdo periudhe.

Per te gjitha asetat e reja si: Prona, impiantet dhe pajisjet janë matur në kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga dëmtimi, nëse ka ndonjë (referojuni tek shënim Nr. 5). Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Zhvlerësimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të jetëgjatësisësë vlerësuar të se cilës pasuri duke përdorur metodën lineare.

Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së tyre tëdoshim. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitime të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat ato lidhen.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese :

| | 2020 | 2019 |
|-------------------------------------|------|------|
| Ndertesa dhe rrjetet e ujësjellësit | 20% | 20% |
| Paisjet tjera dhe Inventari | 5% | 5% |
| Automjetet | 5% | 5% |

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Qiratë e tjera janë qira operative për të cilat pasuritë me qira nuk janë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar të kompanisë. Pagesat e bëra për qiranë operative janë njohur në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në bazë të metodës lineare të afatit të qerasë.

4.3 Tatimi në fitim

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 03/L-162 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave"

Shpenzimet e tatimit për periudhën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përvèç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirese.

Tatimi i shtyrë pasuri njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilët mund të përdoren diferencat e përkohshme. Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që ajo nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Ngarkesa aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjeve tatimore në fuqi ose në datën e raportimit. Menaxhmenti periodikisht vlerëson qëndrimet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore janë subjekt i interpretimit. Ajo përcakton provizione kur është e nevojshme në bazë të shumave që pritet të paguhen në organet tatimore.

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

4. Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.4 Stoqet

Stoqet janë njojur fillimisht sipas kostos ose vlerës së realizueshme neto, varësisht se cila është më e ulët. Kostoja përmban koston e blerjes, koston e shendërrimit, dhe të gjitha kostot shoqëruese të ndodhura për të sjelljë stoqet në vendin dhe gjendjen aktuale. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

4.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në llogaritë operative në bankë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

4.6 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuara nëse i është faturuar Kompanisë apo jo.

4.7 Huazimet

Huazimet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njoftes fillestare kreditë dhe huazimet janë paraqitur me koston e amortizuar dhe çdo diferençë mes kostos dhe vlerës së ripagesës njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përgjatë periudhës së huazimit duke përdorur metoden efektive të interesit.

4.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto e kthimit të konsumatorëve, zbritjet dhe tatimet e lidhura me shitje.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë të përbushura:

- Kompania ka transferuar tek blerësit rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet e pronësisë së mallrave;
- Kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin të rrjedhin tek entiteti; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

4.9 Transaksionet ne valuta te huaja

Transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e kryerjes së transaksioneve. Në çdo datë të bilancit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo monetarë që maten në termat e kostos historike në monedhë të huaj nuk konvertohen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën lindin.

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

4. Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.10 Rënia në vlerë

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë, me përjashtim të stoqeve rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencia për rënie ne vlerë. Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha hyrëse të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përkasin pasuritë.

Në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet, një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme.

4.11 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit në bilancat e bankave të njohura në fitim ose humbje. Të hyrat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën efektive të interesit. Shpenzimet e interesit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit.

4.12 Përfitimet e punonjësve

Kompania nuk ndan asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve më të madha se kontributet e paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

4.12 Kontigjencat dhe provizonet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përvëq nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedha e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Provizioni është njohur nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

4.15 Parimi i vazhdimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdimësisë, e cila supozon realizimin e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

4.16 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishmëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

Supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të vlerësimit të pasigurisë në datën e raportimit, që rrezikojnë të shkaktojnë një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financier, janë diskutuar më poshtë:

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

4. Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.16. Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar (vazhdim)

Detyrimi aktual tatimor

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin që perfundon më 31 dhjetor 2020 i nënshtronen inspektimit nga autoritetet timore vendore, ku menaxhmenti i Kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykin e tij më të mirë, për të qenë në përputhje me ligjet timore. Për shkak të përdorimit të gjykit për të përbushur kërkuesat e caktuara të ligjeve timore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve timore, detyrimi tatimor më 31 dhjetor 2020 mund të ndryshojë në krahasim me atë të raportuar në këto pasqyra financiare.

Provizioni për dëmtim të llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësim për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkates për dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve. Faktoret dhe rrethanat e shqyrtuara nga menaxhmenti me datën e raportimit nuk rezultojnë në provisionim të llogarive të arkëtushme dhe stoqeve.

KRU “Hidrodrini SH.A”

henimet shpieguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(“human ne Euro”)

5. Prona, impiantet dhe pajisjet

| | | | | Rrjeti i ujesjellësit dhe instalimet teknike | Pajisje makinerite, veturat, Ti etj | Pajisje | Investimet ne vijim | Total |
|------------------------------|-----------|-----------|------------|--|---|------------|------------------------|------------|
| Më 1 Janar 2019 | 2,304,250 | 6,214,601 | 24,004,503 | 1,579,397 | 1,421,852 | 35,524,603 | | |
| htesat gjatë vitit | - | 23,644 | 63,641 | 414,689 | 6,327,782 | 6,829,756 | | |
| hyerjet | - | - | - | - | - | - | | |
| Më 31 Dhjetor 2019 | 2,304,250 | 6,238,245 | 24,068,144 | 1,994,086 | 7,749,634 | 42,354,359 | | |
| htesat gjatë vitit | - | 29,935 | 122,614 | 32,493 | 8,382,807 | 8,567,849 | | |
| hyerjet | - | - | - | - | - | - | | |
| Më 31 Dhjetor 2020 | 2,304,250 | 6,268,180 | 24,190,758 | 2,026,579 | 16,132,441 | 50,922,208 | | |
| hvlerësimi i akumulur | | | | | | | | |
| Më 1 Janar 2019 | - | 2,267,270 | 12,201,298 | 1,496,747 | | | - | 15,965,315 |
| hpenzimet e zhvlerësimit | - | 311,222 | 1,185,849 | 77,601 | | | - | 1,574,672 |
| hyerjet | - | - | - | - | - | - | | |
| Më 31 Dhjetor 2019 | - | 2,578,492 | 13,387,147 | 1,574,348 | | | - | 17,539,987 |
| hpenzimet e zhvlerësimit | - | 320,333 | 920,231 | 350,361 | | | - | 1,590,925 |
| hyerjet | - | - | - | (5,544) | | | - | (5,544) |
| Më 31 Dhjetor 2020 | - | 2,898,825 | 14,307,378 | 1,919,165 | | | - | 19,125,368 |
| Iera neto më 31 Dhjetor 2019 | 2,304,250 | 3,659,753 | 10,680,997 | 419,738 | 7,749,634 | 24,814,372 | | |
| Iera neto më 31 Dhjetor 2020 | 2,304,250 | 3,369,355 | 9,883,380 | 107,414 | 16,132,441 | 31,796,840 | | |

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

6. Stoqet

Stoqet janë të përbëra si në vijim:

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|-----------------|--------------------|--------------------|
| Depo Pejë | 411,518 | - |
| Depo Istog | 50,644 | - |
| Depo Klinë | 16,720 | - |
| Depo Junik | 4,035 | - |
| Depo Decan | 26,683 | - |
| Stoku në depo | - | 517,497 |
| Gjithsej | 509,590 | 517,497 |

7. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si në vijim:

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|-------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Kërkesat nga amvisëritë | 18,858,021 | 11,678,612 |
| Lejimi per borxhet e kqija | (6,443,159) | - |
| Llogaritë e arkëtueshme Neto | 12,414,862 | 11,678,612 |
| Te arketueshmet tjera | 116,277 | 119,748 |
| Gjithsej | 12,531,139 | 11,798,360 |

8. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si në vijim:

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|-----------------|--------------------|--------------------|
| Paraja në Arkë | - | 494 |
| Paraja në Bank | 6,061,074 | 7,755,553 |
| Gjithsej | 6,061,074 | 7,756,047 |

9. Te hyrat e shtyra

Te hyrat e shtyra perbehen nga si vijon:

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|-------------------------------|--------------------|--------------------|
| Te hyrat e shtyera KFW | 15,799,888 | 9,901,687 |
| Te hyrat e shtyera CDS Zvicer | 551,421 | 609,692 |
| Te hyrat e shtyera MZHE | 1,142,843 | 1,213,848 |
| Te hyrat e shtyera Komuniteti | 18,743 | 98,365 |
| Te hyrat e shtyera USAID | 1,869,500 | 2,092,890 |
| Te hyrat e shtyera KK Pejë | 2,902,686 | 2,597,481 |
| Te hyrat e shtyera KK Klinë | 1,490,256 | 1,445,783 |
| Te hyrat e shtyera MMPH | 3,800,000 | 3,800,000 |
| Gjithsej | 27,575,337 | 21,759,745 |

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(Shumat ne Euro)

10. Të pagueshmet tregtare dhe te tjera

Të pagueshmet tregtare me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si në vijim:

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|--------------------------------|--------------------|--------------------|
| Te pagueshmet tregtare | 360,431 | 108,465 |
| Llogaritë e tjera të pagueshme | 4,800 | - |
| Detyrimet tjera afatshkurtëra | 12241 | 10,987 |
| Pagat e pagueshme | 243 | (59) |
| Totali | 377,715 | 119,393 |

11. Te pagueshmet tatimore

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|-------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Tatimi ne paga I pagueshem | 10,778 | 9,457 |
| Kontributi pensional i pagueshem | 16,264 | 15,038 |
| Tvsh i pagueshem | 2,247,508 | 2,336,301 |
| Totali I detyrimeve tatimore | 2,274,550 | 2,360,796 |

12. Te hyrat nga shitja dhe te hyrat tjera

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|---|--------------------|--------------------|
| Të hyrat nga shitja/sherbimet | 3,795,599 | 3,914,097 |
| Gjithsej | 3,795,599 | 3,914,097 |
| Te hyrat tjera | | |
| Të hyrat per asetat e zhvlersuara nga grantet | 898,690 | 469,253 |
| Te hyrat nga borgji I keq | 235,110 | - |
| Të hyrat tjera | 60,493 | 58,139 |
| Gjithsej te hyrat tjera | 1,194,293 | 4,441,489 |
| Gjithsej te hyrat | 4,989,892 | 4,441,489 |

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(Shumat ne Euro)

13. Shpenzimet e shperndarjes

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|--|--------------------|--------------------|
| Shpenzimet e Reklames | 5,168 | 3,102 |
| Shpenzimet e Karburanteve | 54,242 | 57,698 |
| Shpenzimet e Qerase | 1,569 | 1,449 |
| Shpenzimet e Sigurimit / Regjistrimit | 13,561 | 15,625 |
| Shpenzimet e Mirembajtjes / Servisimit | 489,123 | 119,580 |
| Shpenzimet e Zhvlersimit | 1,590,925 | 1,574,672 |
| Shpenzimet tjera te shperndarjes | 64,778 | 146,426 |
| Gjithsej | 2,219,366 | 1,918,552 |

14. Shpenzimet e përgjithshme administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative përbëhen si në vijim:

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|---|--------------------|--------------------|
| Shpenzimet e Energjis Elektrike | 510,559 | 474,819 |
| Shpenzimet e Zyres | 22,074 | 18,495 |
| Shpenzimet e perfaqsimit | 4,046 | 5,365 |
| Shpenzimet e Telefonit dhe Internetin | 18,403 | 17,947 |
| Shpenzimet e Donacioneve | 4,623 | 3,950 |
| Shpenzimet Komunale | 374 | 4,284 |
| Shpenzimet e borgjeve te kqija dhe te dyshimta | 95,171 | 62,903 |
| Shpenzimet materiale dhe administrative | 21,641 | - |
| Shpenzimet e ngrohjes,mbeturinave dhe rrjetit te ujit | 6,918 | - |
| Shpenzimet e jashtme profesionale dhe udhetimet zyrtare | 55,541 | - |
| Shpenzimet e provisionit bankar | 4,369 | - |
| Shpenzimet e analizave te ujit dhe klorit | 26,360 | - |
| Shpenzimet e pagave | 1,673,180 | 1,687,785 |
| Gjithsej | 2,443,259 | 2,275,548 |

14.1 Shpenzimet e personelit

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Shpenzimet e pagave | 1,593,596 | 1,607,916 |
| Kontibuti Pensional i punedhenesit | 79,584 | 88,185 |
| Totali shpenzimet e pagave | 1,673,180 | 1,687,785 |

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

15. Shpenzimet e tatimit në fitim

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Fitimi para tatimit | 327,267 | 247,338 |
| <i>Rregulluar për:</i> | | |
| Shpenzimet e pazbritshme | - | 90,122 |
| Fitimi para tatimit | - | 337,460 |
| Shpenzimet e tatimit (10 %) | - | 33,746 |

16. Zotimet dhe kontingjentet

(i) Zotimet

Kompania nuk ka hyrë në zotime kontingjencia per vitin më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

(ii) Kontestet

Me 31 dhjetor 2020 Kompania është e përfshirë në çështje gjyqësore nga aktiviteti normal i biznesit si pale e paditur.

17. Instrumentet financiare

(i) Rreziku kreditor

Instrumentet financiare të cilat potencialisht e ekspozojnë kompaninë ndaj përqendrimeve të rrezikut kreditor përbëhen kryesisht nga balancat e të arkëtueshmeve dhe të parave të gatshme. Eksposimi i Kompanisë ndaj rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Kompania ka krijuar një politikë kreditore nën të cilën secili klient i ri analizohet individualisht për besueshmëri para se termet dhe kushtet e pagesës dhe të dërgesës të ofrohen. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollohet me anë të aprovimeve të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve buxhetore që i gjenerojnë të arkëtueshmet e tillë. Rreziku kreditor në paratë e gatshme kontrollohet duke investuar në bankat me reputacion në Kosovë.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe ato të Kosovës

Kriza e vazhdueshme botërore financiare dhe kriza ekonomike ka rezultuar në, ndër të tjera, një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitaleve, nivele më të ulëta të likuiditetit në sektorin bankar, dhe, kohë pas kohe, norma më të larta nderbanksare interesë dhe paqëndrueshmëri më të lartë në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë rezultuar edhe në dështime të bankave dhe shpëtime të bankave në të gjithë botën. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare së vazhdueshme po dëshmon të jetë e pamundur për t'u parashikuar ose për tu mbrojtur plotësisht nga ajo.

(ii) Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranohen dhe shpenzohen në Euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

(iii) Vlera e drejtë

Kompania ka pasuri financiare të cilat përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj. Kompania ka detyrime financiare të cilat përbëhen nga akrualat, të pagueshmet e tjera. Vlerat e drejta të këtyre instrumenteve financiare nuk janë materialisht të ndryshme nga vlera e tyre e deklaruar për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër ose kushteve të tjera.

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(Shumat ne Euro)

17 . Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interest të tregut duke pasur parasysh se shumica e financimit sigurohet nga kompania mëmë.

(v) Rreziku i likuiditetit

Në vijim janë maturimet kontraktuale të detyrimeve financiare, duke përjashtuar ndikimin e marrveshjeve mbi kompenzimin:

| | Më pak se 1 muaj | 1 deri në 12 muaj | 1 deri në 5 vite | Gjithsej |
|---------------------------------------|------------------|--------------------|-------------------|-------------------|
| 31 dhjetor 2020 | | | | |
| Pasuria | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentet e saj | 6,061,074 | - | - | 6,061,074 |
| Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera | - | - | 12,531,139 | 12,531,139 |
| Gjithsej pasuria | 6,061,074 | - | 12,531,139 | 18,592,213 |
| Detyrimet | | | | |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera | - | 377,715 | - | 377,715 |
| Grantet e shtyra | - | 2,274,550 | - | 2,274,550 |
| Gjithsej detyrimet | - | 2,652,265 | - | 2,652,265 |
| Pozicioni i likuiditetit | 6,061,074 | (2,652,265) | 12,531,139 | 15,939,948 |
| Hendeku i likuiditetit neto | 6,061,074 | 3,408,809 | 15,939,948 | |
| 31 dhjetor 2019 | | | | |
| Pasuria | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentet e saj | 7,756,047 | - | - | 7,756,047 |
| Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera | - | - | 11,798,360 | 11,798,360 |
| Gjithsej pasuria | 7,756,047 | - | 11,798,360 | 19,554,407 |
| Detyrimet | | | | |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera | - | 119,393 | - | 119,393 |
| Grantet e shtyra | - | 2,360,794 | - | 2,360,794 |
| Gjithsej detyrimet | - | 2,480,187 | - | 2,480,187 |
| Pozicioni i likuiditetit | 7,756,047 | (2,480,187) | 11,798,360 | 17,074,220 |
| Hendeku i likuiditetit neto | 7,756,047 | 5,275,860 | 17,074,220 | |

KRU “Hidrodrini SH.A”

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2020
(*Shumat ne Euro*)

18. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura nësë njëra palë e ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjeter në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontrollë të përbashkët me kompanisë. Në palët e lidhura përfshihet dhe personeli kyç në menaxhimin e kompanisë. Kompenzimet e menaxhmentit per vitin qe perfundon me 31 Dhejtor 2020 jane si vijon:

| | <u>31 Dhjetor 2020</u> | <u>31 Dhjetor 2019</u> |
|-----------------|------------------------|------------------------|
| Menaxhmenti kyq | 24,493 | - |

19. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalosje në pasqyrat e vecanta financiare.